



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja Nr. 93

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

Prishtinë, më 26 Shkurt 2014, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Faton Topalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.2.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

Kryetari fillimisht e paraqiti rendin e ditës para anëtarëve të Komisionit, njëherësh propozoi që ky rend i ditës të ndryshohet duke propozuar që të futet si pikë e rendit të ditës.

Shqyrtimi i Projektligjit për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, para miratimit në parim;

Komisioni njëzëri vendosi që të plotësohet rendi i ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryetari Fikrim Damka.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës: 14.2.2014;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.2.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;

Fikrim Damka tha se si Komision, do të shqyrtojmë përsëri Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili është kthyer përsëri në Komision nga seanca, pas kërkesës së disa grupeve parlamentare, që ky Projektligj të hiqet prej rendit të ditës dhe ti kthehet Komisionit edhe njëherë për plotësim, shqyrtimin e amendamenteve të komisioneve tjera dhe propozimeve të grupeve parlamentare.

Ne si komision, tha ai, kemi shqyrtuar dhe punuar gjatë në këtë projektligj, për secilin amendament duke pasur edhe një varg debatesh e diskutimesh. E dimë se ndoshta disa amendamente nuk janë të favorshme për të gjithë, mirëpo, duke pasur parasysh vërejtjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa e edhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë, përkundër këtyre vërejtjeve, ne si komision jemi pajtuar që të përkrahim këtë projektligj dhe ta procedojmë për miratim në seancë. Duhet ta rishqyrtojmë projektligjin si dhe amendamentet të cilat janë kontestuese.

Të vazhdojmë edhe njëherë me shqyrtimin e atyre amendamenteve kyçe, të cilat janë diskutuar në seancë, andaj kërkoj mendimin tuaj lidhur me këto amendamente.

Salihe Mustafi –Siç tha edhe kryetari, ne si Komision kemi punuar gjatë në këtë projektligj, dhe duke e ditur rëndësinë e këtij projektligji, e kemi proceduar për miratim në seancë, mirëpo, ai është kthyer përsëri në Komision. Propozoj që ti dëgjojmë arsyet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të cilët e kanë kundërshtuar Projektligjin në seance dhe të na japin arsyet e tyre, pse kanë kërkuar që të kthehet prapë në Komision. Mendoj është dashur që atë ditë të shqyrtohet Projektligji në seancë dhe për amendamentet të cilat kanë qenë pa përkrahjen e Komisionit Funksional, të vendosë seanca. Ne këtë mënyrë ky projektligj vetëm po zvarritet.

Faton Topalli tha se Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes, në vazhdimësi e ka kundërshtuar këtë projektligj se si e ka propozuar Qeveria në këtë mënyrë. Konsiderojmë se është vlerë për tu përkujdesur për njerëzit dhe mjetet që janë paraparë për këto kategori në këtë projektligj dhe vlerësojmë se nuk janë përkujdesje por lëmoshë për këto kategori, dhe nuk e sigurojnë as minimumin jetësor. Prandaj e kundërshtojmë këtë projektligj. Qeveria ka pasur kohë të gjatë tash 15 vjet, dhe nuk e ka nxjerr një ligj të mirë. Quhet Projektligj për pensionet, e në fakt nuk ka të përbashkët asgjë me pensionet.

Andaj, ne si grup parlamentar, kërkojmë që ky projektligj ti kthehet Qeverisë, që ta përgatisë më mirë, duke marre parasysh edhe praktikën e vendeve të rajonit, e edhe të vendeve tjera, që të kemi një projektligj për pensionistët, i cili siguron jetë së paku me dinjitet.

Bahri Thaçi tha se kemi vend për përmirësimet e nevojshme pa e dëmtuar projektligjin, saktësisht të Nenit 8, paragrafi 1, pika 1.2., ku thuhet “duhet të ketë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) vjet stazh pensionale, para datës 1.1.1999, prej të cilave së paku 7 vite e 7 muaj të jenë stazh pune në Kosovë”. Nëse e analizojmë mirë, pse duhet të ketë stazh 15 vjet, para vitit 1999, dihet mirë se çfarë situate apo sistemi ka mbretëruar në Kosovë, pas viteve 90-ta dhe kush ka punuar,

dhe kush mund të këtë stazh gjatë këtyre viteve. Rekomandoj që të behët një riformulim në këtë mënyrë, “ Të gjithë ata që kanë punuar në institucione publike të Kosovës, dhe kanë pasur një stazh pune, së paku 5 vjet para vitit 1990”. Mjaft është abuzuar me klasën punëtore në atë kohë, tash me këtë projektligj, në njëfarë mënyre ne edhe njëherë po i diskriminojmë, pasi që në një farë mënyre po dalin në pozitë më të mirë ata që kanë punuar në institucione në atë kohë, se sa ata që me dhunë janë përjashtuar nga vendi i tyre i punës, gjatë periudhës së viteve të 90-ta. Kështu që unë rekomandoj që ky amendament të riformulohet në këtë mënyrë: Ai që ka 5 vjet stazh pune, deri në vitin 1990 dhe ka paguar kontributet, mund të gëzojë pensionin kontributdhënës”. Kjo nuk e dëmton substancën e këtij projektligji. Është e vërtetë se ky projektligj është stërzgatur dhe të gjithëve po ju ngutet e më së shumti kategorive që përfitojnë nga ky Projektligj, në këtë rast pensionistëve.

Fikrim Damka pyeti z. Thaçi se a është ky qëndrim i Grupit Parlamentar të LDK-së, apo qëndrim i tij personal.

Bahri Thaçi tha se ky është qëndrimi i tij personal, e edhe i grupit .

Po ashtu kemi vërejtje tek amendamenti 7, me ç’rast rekomandojmë që të bëhet riformulim i tij si vijon: “E drejta në pension ju njihet punëtorëve të arsimit dhe punëtorëve të tjerë, të larguar me dhunë nga puna”.

Fikrim Damka tha se kemi pranuar edhe një shkresë zyrtare nga z. Shaban Kajtazi, nga Shoqata e Pensionistëve të Kosovës. Përmes kësaj shkrese, ata kërkojnë që sa më parë të miratohet ky projektligj. Atëherë nëse mund të vazhdojmë më konkretisht, mos të ndalemi shumë në debate apo diskutime, pra të vazhdojmë me propozimet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i LDK-së, që „15 vite stazh” të zëvendësohet me „ 5 vite stazh pune, para vitit 1990”.

Gjithashtu kam pranuar një kërkesë lidhur me amendamentin 19, paragrafi 1, pika 1.2, ku thuhet *“Në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshtetësinë e shtetit, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale”*, në këtë rast kemi një kërkesë që amendamenti të fshihet dhe të mbetet si në projektligj e që thotë „ *Në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, vendoset në ndonjë shtet tjetër me banim të përhershëm, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale”*.

Pas diskutimeve rreth propozimit për ndryshimin e amendamentit 19, të gjithë anëtarët e Komisionit u pajtuan që të riformulohet ky amendament si vijon *„Në rast se përfituesi i pensionit bazik të moshës dhe i aftësisë së kufizuar, fiton nënshtetësinë e shtetit tjetër dhe është banor rezident në atë shtet, me të cilin Republika e Kosovës, nuk ka Marrëveshje Bilaterale për sigurime sociale”*.

Fikrim Damka tha se sa i përket këtyre pikave, konsideroj se mjaft u diskutua, atëherë kërkoj nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare që në vazhdimin e mbledhjes, që do të mbahet më 27.2.2014, të deklarojnë qëndrimin e grupeve të tyre parlamentare, lidhur me këto propozime apo amendamente, të cilat u diskutuan sot. Kurse nga grupi parlamentar i LDK-së, kërkoj që të dorëzojnë me shkrim propozimin e tyre, lidhur me Nenin 8, paragrafi 1.2 dhe amendamentin 7.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, para miratimit në parim;

Fikrim Damka tha se të gjithë e keni marr këtë projektligj dhe besoj se të gjithë e keni lexuar. Unë vlerësoj se i plotëson kushtet që të procedohet në seancë, për miratim në parim apo leximin e parë, mandej gjatë punës në komision, të gjithë mund të jepni kontributin tuaj.

Komisioni njëzëri vendosi që projektligji të procedohet për seancë, për miratim në parim.

5. Të ndryshme.

Kryetari tha se siç jeni në dijeni, kemi një numër të madh të projektligjeve, të cilat kanë kaluar leximin e parë dhe tash si komision duhet të fillojmë të punojmë në këto projektligje.

Andaj rekomandoj që për Projektligjin për Sigurimet Shëndetësore të mbajmë një dëgjim publik, më 5.3.2014, ditën e mërkurë, në orën 11:00, kurse më 10 e 11 mars 2014, të mbajmë një punëtori në Prevallë, ku si komision do të punojmë në projektligjin për Sigurimet shëndetësore.

Komisioni njëzëri vendosi që të mbahet dëgjimi dhe punëtorja për Projektligjin për Sigurimet Shëndetësore.

Kryetari kërkoi që mbledhja të vazhdojë nesër.

Vazhdimi i mbledhjes:

Mbledhja Nr. 93

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N - 303

Prishtinë, më 27 shkurt 2014, në orën 14:00

Fikrim Damka konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe vazhdimin e mbledhjes së datës: 26.2.2014, lidhur me amendamentet që janë diskutuar në mbledhjen e kaluar. Shpresojmë se grupi parlamentar i LDK-së, i ka sjellë qëndrimet e tyre tha ai dhe e hapi diskutimin .

Nazane Breca tha se Grupi Parlamentar i LDK-së është takuar dje dhe ka vendosur që të përkrahë amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian, andaj, kërkoj nga të gjithë ju mbështetje, dhe si komision t'i përkrahim këto propozime dhe këto amendamente të shkojnë me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Bahri Thaçi tha se e përkrah këtë qëndrim të Grupit Parlamentar të LDK së, dhe kërkoj nga ju mbështetje si komision, ti përkrahim këto propozime dhe të shkojnë me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Komisioni diskutoi lidhur me propozimet e prezantuara nga përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të LDK së. Të gjithë anëtarët e tjerë, me përjashtim të përfaqësuesve të Grupit Parlamentar të LDK-së, vendosën që raporti të procedohet në seancë i pandryshuar, ndërsa seanca të vendos

nëse do ti përkrah amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian, apo do të mbetet propozimi si në Projektligj.

Fikrim Damka tha se mund të shkojmë me këto dy propozime dhe seanca pastaj të vendosë se cilin propozim e përkrahë, pasi që propozimi i Grupit Parlamentar të LDK së, nuk u përkrah nga anëtarët tjerë të Komisionit.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka